



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri: KSC-BC-2019-02

Vendosi: Paneli i përbërë prej një gjykatësi të vetëm
Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 27 shkurt 2019

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

URDHËR

**Administratores për dërgimin e dokumenteve lidhur me vendimin
KSC/REG/IOR/1632**

Parashtruesi

Z. Ruzhdi Saramati

GJYKATËSI I VETËM është ngarkuar me shqyrtimin e kërkesës së parashtruar nga z. Ruzhdi Saramati (“Parashtruesi”) më 23 shkurt 2019 (“Kërkesë për rishikim”),¹ për rishikimin e vendimit të Administratores në lidhje me ndihmën juridike, Ref: KSC/REG/IOR/1632, të datës 18 shkurt 2019 (“Vendim në lidhje me ndihmën juridike”) dhe në vijim urdhëron Administratoren t’i dërgojë dokumente gjykatësit të vetëm.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 18 shkurt 2019, Administratorja nxori vendimin në lidhje me ndihmën juridike për refuzimin e kërkesës për ndihmë juridike të dorëzuar nga Parashtruesi (“Kërkesë për ndihmë juridike”).
2. Më 23 shkurt 2019, Parashtruesi dorëzoi kërkesën për rishikim, e cila u mor nga Kryetarja e Dhomave të Specializuara të Kosovës më 25 shkurt 2019.²
3. Më 26 shkurt 2019, Kryetarja e Dhomave të Specializuara të Kosovës caktoi një gjykatës të vetëm për rishikimin e vendimit në lidhje me ndihmën juridike.³

II. PARASHTRIME

4. Në kërkesën e tij për rishikim, Parashtruesi argumenton se Administratorja ka bërë “vërtetim të gabuar të gjendjes faktike,” ndërkohë që ai i kishte “plotësuar të gjitha kushtet për fitimin e të drejtës për ndihmë juridike falas [...] që vërtetohet në bazë të të gjitha provave të cilat i janë bashkëngjitur shkresave për vendosje nga Administratorja [...]”⁴

¹ KSC-BC-2019-02, F00001, Parashtruesi, *Kërkesë për rishikimin e vendimit*, 23 shkurt 2019, publike.

² DHSK, shpërndarë përmes postës së brendshme elektronike nga Njësia për Administrimin e Gjykatës, 25 shkurt 2019.

³ KSC-BC-2019-02, F00002, Kryetarja, *Vendim për caktimin e një gjykatësi të vetëm në përputhje me nenin 33(2) të Ligjit për rishikimin e vendimit të Administratores të datës 18 shkurt 2019 në lidhje me ndihmën juridike*, 26 shkurt 2019, publik (“Vendimi i Kryetares”).

⁴ Kërkesë për rishikim, f. 1-2.

5. Më konkretisht, Parashtruesi pretendon se ai ka dorëzuar “të gjitha informacionet e besueshme dhe të vërtetuara lidhur me 3 llogaritë të cilat i [ka] të vetmet në qarkullimin [e tij] bankar,” dhe për rrjedhojë kërkon që të bëhen verifikime në lidhje me këto llogari bankare për të vërtetuar që kjo listë është shteruese.⁵

6. Gjithashtu, Parashtruesi argumenton se Administratorja ka gabuar në nxjerrjen e përfundimit se ai e ka “informuar gabimisht për llogari të tjera bankare,” dhe pretendon se ai veç “ka shtuar edhe llogarinë e tretë bankare në dy llogaritë bankare në të cilat dyshon [Administratorja].”⁶

7. Së fundi, Parashtruesi argumenton se Administratorja ka gabuar në nxjerrjen e përfundimit se ai nuk ka dhënë informacion për automjetin e tij, sepse “nuk është kërkuar nga Administratorja automjeti për t’u deklaruar,” ndërkohë që Parashtruesi “plotësisht ka dërguar informacionet për automjetin” pas kërkesës së Administratores për ta bërë këtë.⁷

8. Si rrjedhojë, Parashtruesi kërkon rishikimin e kërkesës së tij për ndihmë juridike “nga aspekti jo vetëm formal por edhe material në bazë të dokumentacionit i cili është kërkuar dhe të cilin [ai ia ka] dërguar [Administratores] në tërësi.”⁸

III. LIGJI I ZBATUESHËM

9. Në bazë të nenit 34(7) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, Zyra Administrative përfshin një Zyrë të Mbrojtjes e cila administron një sistem të ndihmës juridike për përfaqësimin e të akuzuarve të varfër ose pjesërisht të varfër para Dhomave të Specializuara të Kosovës.

⁵ Kërkesë për rishikim, para. 1.

⁶ Kërkesë për rishikim, para. 2.

⁷ Kërkesë për rishikim, para. 3.

⁸ Kërkesë për rishikim, f. 3.

10. Udhëzuesi i Përkohshëm i Punës mbi kërkesat për caktimin e mbrojtësve dhe për ndihmë juridike përcakton kushtet dhe procedurën për kërkimin e ndihmës juridike dhe për miratimin apo refuzimin e saj.⁹ Në bazë të rregullave 11 dhe 17 të Rregullores së Përkohshme për Ndihmë Juridike, çdo vendim i Administratores, përfshirë edhe në lidhje me kërkesat për ndihmë juridike, mund t'i nënshtrohet rishikimit, ndër të tjera, nga një gjykatës i vetëm i caktuar për atë qëllim prej Kryetares, pas marrjes së kërkesës së personit që është objekt i vendimit.¹⁰

IV. VENDIM

11. Për qëllim të marrjes së vendimit në lidhje me kërkesën për rishikim, gjykatësi i vetëm urdhëron Administratoren të dorëzojë dokumentet e mëposhtme deri ditën e premte, 1 mars 2019:

- a. Kërkesën për ndihmë juridike të dorëzuar nga Parashtruesi, përfshirë të gjitha dokumentet shoqëruese dhe përkthimet e tyre në anglishte;
- b. çfarëdo Formulari për Deklarimin e Mjeteve Financiare të dorëzuar nga Parashtruesi, përfshirë të gjitha dokumentet shoqëruese dhe përkthimet e tyre në anglishte;
- c. vendimin në lidhje me ndihmën juridike, përfshirë të gjitha shtojcat e tij;
- d. çdo vlerësim të mëtejshëm të kryer nga Administratorja lidhur me varfërinë e Parashtruesit;
- e. çfarëdo rregulloreje të brendshme dhe shtojcat përkatëse, nëse ka, mbi bazën e të cilave është bërë vlerësimi i varfërisë dhe është marrë vendimi në lidhje me ndihmën juridike dhe

⁹ krahaso: Vendimi i Kryetares, para. 4.

¹⁰ krahaso: Vendimi i Kryetares, para. 4.

f. çfarëdo dokumenti tjetër që ka lidhje me vlerësimin e kërkesës për rishikim.

12. Gjithashtu, Administratorja mund t'i dorëzojë gjykatësit të vetëm parashtrimet e saj në përgjigje të kërkesës për rishikim deri ditën e enjte, 7 mars 2019.

/nënshkrim/

Gjykatësi Nikola Giju
Gjykatës i vetëm

E mërkurë, 27 shkurt 2019
Hagë, Holandë.